



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. ____ Prot.,

Tiranë më _____.____.2025

VENDIM

Nr.17, datë 14.10.2025

PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT INDIVIDUAL SHOQËRISË “POSTA SHQIPTARE”
SH.A., PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me përbërje:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 14 tetor 2025, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it, miratuar me vendimin nr.07, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP-it, e ndryshuar shqyrtoi çështjen me objekt:

- ***Për Dhënie e Autorizimit Individual shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a për ofrimin e Shërbimit Universal Postar.***

BAZA LIGJORE:

1. Pika 1 e nenit 7, pikat 1 dhe 6 të nenit 9, dhe pika 3 e nenit 64 të ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”.
2. Pika 1 e nenit 14 dhe pika 1 e nenit 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
3. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”.
4. Neni 7 i Vendimi të Këshillit të Ministrave (KM) nr. 239 datë 02.05.2018 “Për miratimin

- e Rregullave për përcaktimin e Ofruesit të Shërbimit Universal Postar”.
5. Urdhëri i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, nr. 469 datë 27.12.2019 “Për përcaktimin e dendësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar”.
 6. Rregullore e AKEP, nr. 36 datë 29.10.2015, “Për ofrimin e shërbimit universal postar”.
 7. Vendim i Këshillit Drejtues të AKEP nr. 10, datë 27.08.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar “Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimit të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal”.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor:

- Dokumenti “Autorizim Individual i shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a., për ofrimin e shërbimit universal postar”;
- Relacioni shoqërues i projektaktit;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 13, datë 30.06.2020, shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a., është pajisur me Autorizim Individual, për ofrimin e shërbimit universal postar, me afat 5 vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Me VKD nr. 06, datë 19.05.2025, është miratuar për këshillim publik, dokumenti “*Analizë e Tregut të Shërbimeve Postare dhe vlerësimit i ofruesve të mundshëm të Shërbimit Universal*”. Në përfundim të këshillimit publik, me VKD nr. 10, datë 27.08.2025 “*Për miratimin e dokumentit përfundimtar: Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimit të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal*”, Këshilli Drejtues ka përcaktuar shoqërinë “Posta Shqiptare” sh.a., si ofruesi i vetëm që plotëson kushtet ligjore për të ofruar shërbimin universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Lëshimi i Autorizimit Individual për Ofruesin e Shërbimit Universal Postar, bazohet në përcaktimet e ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, Rregulloren nr. 36 datë 29.10.2015 “Për ofrimin e shërbimit universal postar”, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Autorizimi Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, vendos të drejta dhe detyrime për shoqërinë “Posta Shqiptare” sh.a., për të ofruar shërbimin universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe pikën 1 të nenit 7, pikat 1 dhe 6 të nenit 9,

dhe pikën 3 të nenit 64 të ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Dhënien e Autorizimit Individual, shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a., për ofrimin e shërbimit universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi, për një periudhë 5 vjeçare duke filluar nga data 07 korrik 2025.
2. Shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a., ka detyrimin të ofrojë shërbimin universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas kushteve të Autorizimit Individual të miratuar me këtë vendim si dhe sipas përcaktimeve të ligjit nr. 46/2015, datë 07.05.2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore dhe rregullatore të sektorit postar.
3. Ky vendim i fillon efektet nga data 07 korrik 2025.

Vendimi publikohet në faqen web të AKEP: www.akep.al.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka